



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:028970
Datë: 26.04.2024
Numri i dokumentit: 05629998

KPPP.nr.1828/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Kompania Rajonale e Mbeturinave “Pastrimi” SH.A., me seli në rr. “Bill Klinton” p.n, në Prishtinë, kundër debitorit Avokat Luljeta Gjinovci, NRB: 70861909, me seli në rr. “Ilir Konushevc” nr. 11, në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Aktvendimit Përmbartimor E.nr.1286/13 të datës 10.12.2013, të Gjykatës Themelore në Prishtinë, jashtë seancës, me datën 26.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit Avokat Luljeta Gjinovci, dhe aktvendimi përmbartimor E.nr.1286/13 i datës 10.12.2013, i lejuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë SHFUQIZOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Kompania Rajonale e Mbeturinave “Pastrimi” SH.A., ka caktuar aktvendimin për përmbartim E.nr.1286/13 të datës 10.12.2013, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm: Ekstraktet nga librat afariste me nr. ID 8968, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit, t’i paguaj kreditorit borxhin prej 372.87 € me kamatë ligjore

sipas normës vjetore për mjetet e deponuara në bankat komerciale pa destinim të caktuar në afat prej një viti, duke filluar nga dita e paraqitjes së propozimit e deri në ditën e pagesës, si dhe shpenzimet e përmbarimit, me ndalimin e mjeteve në para të cilat debitori i ka në llogaritë bankare, si dhe bartjen e shumës përkatëse në llogari të kreditorit, ndërsa nëse debitori ka mjete në llogarinë e tij, përmbarimi të bëhet me regjistrimin, konfiskimin dhe shitjen e sendeve të luajshme të debitorit dhe bartjen e tyre në llogarinë e kreditorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi aktvendimin përmbarimor, duke deklaruar se ekstrakti nga librat afariste nuk përbën dokument ekzekutiv. Më tutje ka shtuar se aktvendimi i atakuar është kundërthënës me vetveten dhe në të nuk janë shtruar arsyet mbi faktet vendimtare dhe arsyet e parashtuara në propozimin për përmbarim janë jo të sakta dhe kontradiktore me përmbajtjen e gjendjes faktike. Në lidhje me shumën e cekur si në propozim ka theksuar se i është paguar pronarit të lokalit afarist, ashtu që janë përmbushur të gjitha obligimet kontraktuese. Gjykatës i ka propozuar që të aprovohet kundërshtimi i debitorit, të ndërpritet ekzekutimi i caktuar me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe të ndalohen dhe të abrogohen në tërësi veprimet e ndërmarra.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar, andaj të njëjtin e aprovoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.2 të këtij neni ekstraktet e verifikuara nga librat afariste përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë original apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*

Gjykata duke u bazuar në ekstraktet e verifikuara nga librat afariste të lartcekura, në bazë të së cilave është mbështetur propozimi për përmbarrim gjeti se të njëjtat janë bashkëngjitur në kopje, ndërsa në shkresat e lëndës nuk është deponuar origjinali apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit, e rrjedhimisht propozimi për përmbarrim është paraqitur në kundërshtim me nenin 38 par.1 të LPP-së i cili përcakton se *“Propozimi për përmbarrim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbarrim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbarrimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm..”*

Bazuar në dispozitën e sipërcituar, gjykata gjeti se në rastin konkret aktvendimi përmbarrimor E.nr.1286/13 i datës 10.12.2013, është nxjerrë pa plotësimin e kushteve për lejimin e përmbarrimit, ngase propozimi për përmbarrim bazohet në një dokument kopje dhe si i tillë përmban të meta në kuptim të nenit 38, paragrafi 1 të LPP-së, të cilat në këtë fazë të procedurës nuk mund të evitohen nga gjykata, ngase në fazën e mjetit juridik, gjykata kufizohet vetëm në shqyrtimin e përshtatshmërisë së dokumentit mbi bazën e së cilit është lejuar aktvendimi për përmbarrim si dhe ligjshmërinë e këtij aktvendimi përmbarrimor.

Meqenëse në rastin konkret, sipas vlerësimit të gjykatës nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e aktvendimit për përmbarrim, ndërsa organi përmbarrues - gjykata, nuk ka vepruar konform nenit 38, paragrafi 2 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se *“Në rast se propozimi për përmbarrim nga paragrafin 1. i këtij neni nuk përmban shënimet e kërkuara dhe numrin personal identifikues apo numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, organi përmbarrues do të veprojë sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore”*, gjykata shfuqizoi aktvendimin përmbarrimor dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga sa më sipër, gjykata në mbështetje të nenit 43, nenit 71 dhe nenit 73 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1828/23, datë 26.04.2024

Gjyqtari
Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komeriale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.